Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomikshënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sgarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

ç) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;



- 
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
  6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
  7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

d) Norma e fitimit e shprehur nëvlere absolute ështëi më poshtë

<b>1</b>	<b>2</b>	<b>3</b>
<b>Nr</b>	<b>Përshkrimi i mallrave</b>	<b>Norma e fitimit</b>

<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>	
<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë</b> _____	

**Shtojca2.**

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik )

**LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE**

**Data:** \_\_\_\_\_

**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:** \_\_\_\_\_

**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):**  
\_\_\_\_\_

**Monedha:** \_\_\_\_\_

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Sasisë dhe grafikut për Mallratduhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimevepër artikujt. Artikujt pa çmim do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të cojë në refuzimin e ofertës.

**Lista e Çmimeve**

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>6</i>	
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia	çmimi per njësi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	<b>Çmimi total (Mallrat)</b>				_____
<b>Çmimi Neto pa TVSH</b>					
<b>TVSH (%)</b>					
<b>Çmimi total me TVSH:</b>					

---

<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b> <b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë</b> _____	

---

### Shtojca 3.

[ Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)  
[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

## FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

\* \* \*

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr.Referencës në faqen e APP-së

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

---

#### **Shtojca 4.**

*(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)*

#### **Lista e Informacionit Konfidencial**

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

#### **VËMENDJE**

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### **Përfaqësuesi i Ofertuesit**

#### **Nënshkrimi**

#### **Vula**

## Shtojca 5.

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor ]

### FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Specifikimi i Materialeve:

Nr.	EMËRTIMI I MALLIT	SPECIFIKIME TEKNIKE
1.	Makarona spageti (të gjata)	Forma: Makarona spageti me gjatësi 25-30 cm, me diametër 2-2.5 mm. Pamja e jashtme: Në formë të rregullt, të plota, me sipërfaqe të lëmuar deri lehtësisht të ashpër Ngjyra: E bardhë me nuancë të verdhë Lagështia: jo më shumë se 13% Aciditeti: acid sulfurik jo më shumë se 0,16% Amballazhimi: Makaronat të jenë të ambalazhuara në qese polietileni 0,5–1 Kg me afat skadimi jo më pak se 1 vitë nga data e lëvrimit të mallit.
2.	Makarona fidhe (të shkurtra)	Makarona ngjyrë e verdhë e lehtë. Pamja e jashtme me formë të rregullt, me sipërfaqe të lëmuar, lehtësisht në të ashpër. Pas zierjes të kenë konsistence elastike. Te mos qulloset e të mos çahet. Të kenë rritje të vëllimit. Dëmtues dhe insekte hambari nuk lejohen. Lagështira jo më shumë se 15%. Aciditeti deri 14%. Përbërja të jete e njëjtë por forma të jetë e ndryshme (flutur, fidhe, yll, tubo klitharaq, etj). Amballazhimi: Makaronat të jenë të ambalazhuara në qese polietileni 0,5–1 Kg, me afat skadimi jo më pak se 1 vitë nga data e lëvrimit të mallit.
3.	Oriz (kokër rrumbullakë)	Oriz: pamja e jashtme kokrra të rrumbullakta, të pastra, jo të thyera, të zhveshura pa shenja myku apo prishje, ngjyra e bardhë. Lagështia jo më shumë se

		15%. Lëndë e huaj jo më shumë se 0.4%. Me paketim 1 kg në qese plasmasi dhe afati i skadencës jo me pak se 1 vit nga data e lëvrimit të mallit.
4.	Sheqer i bardhë	Sheqer: pamja e jashtme pluhur i përbërë nga kristale të imta dhe të njëllajta, pa copa sheqeri të ngjeshura ose të huaja. Të jetë i derdhur, i thatë në të prekur dhe të mos ngjitet. Ngjyra e bardhë dhe me shkëlqim me shije të ëmbël, pa shije dhe erë të huaj, i tretshëm plotësisht në ujë. Sheqeri i pastër i llogaritur në lëndë absolutisht të thata 99.6%. Lëndë reduktuese jo më shumë se 0.1%, hiri jo më shumë se 0.07%. Lageshtia jo më shumë se 0.16%. I paketuar me letër 1 kg dhe afati i skadencës jo më pak se 1 vit data e lëvrimit të mallit.
5.	Fasule	Pamja e jashtme: Kokrra të plota, të shëndosha, me formë dhe madhësi sipas llojit (ovale, e rrumbullakët, e gjatë etj). Të jetë e bardhë, pa erë myku dhe çfarëdo erë tjetër të huaj. Pas zierjes të ketë erë të këndshme, pa shije të hidhur ose çfarëdo erë tjetër të huaj. Lageshtia jo më shumë se 15%, lëndë të huaja jo më shumë se 0.8%. Dëmtime nga insektet nuk lejohen. Paketimi me peshë 1 kg dhe afati i skadencës jo më pak se 1 vitë data e lëvrimit të mallit.
6.	Miell gruri	Lloji: Miell Gruri me rreze 80 %. Treguesit shqisor: Ngjyra e bardhë me nuancë të lehtë në të verdhë në varësi të llojit të grurit. Pjesëzat e himeve janë të padukshme me rreze 80 %. Era dhe shija: karakteristik e miellit të grurit, pa erë myku, pa shije të hidhur, të thartë dhe pa erë e shije të huaj. Lageshtira jo më shumë se 14%. Aciditeti i shprehur në acid sulfurik në lëndët absolutisht të thata, jo më shumë se 0.115%. I paketuar me letër 1 kg dhe afati i skadencës jo më pak se 1 vit data e lëvrimit të mallit.
7.	Miell misri	Lloji: Miell Misri. Treguesit shqisor: Ngjyra e bardhë me nuancë të lehtë në të verdhë në varësi të llojit të misrit. Era dhe shija: karakteristik e miellit të misrit, pa erë myku, pa shije të hidhur, të thartë dhe pa erë e shije të huaj.

		<p>Lagështira jo më shumë se 14%.</p> <p>I paketuar me letër/plasmas 1 kg dhe afati i skadencës jo më pak se 1 vitë data e lëvrimit të mallit.</p>
8.	Vaj gjelle (luledielli)	<p>Vaj vegjetal i rafinuar, lëng vajor i qartë pa deponime. Ngjyra e verdhë me nuancë të lehtë portokalli, era karakteristike e vajit të lulediellit, pa shije e lëndë të huaja. Aciditeti jo më shumë se 0.5 %, densiteti 0.913-0.927. Lagështia jo më shumë se 0.2%.</p> <p>E ambalazhuar në bidona 1-5 litër. Afati i skadencës jo më pak se 1 vitë data e lëvrimit të mallit.</p>
9.	Vaj ulliri	<p>Pamja e jashtme të jetë e kthjellët dhe pa asnjë turbullirë.</p> <p>Ngjyra të jetë e verdhë deri në lehtësisht jeshile.</p> <p>Era dhe shija karakteristike të vajit të ullirit. Nuk duhet të përmbajë lëndë të huaja, të jetë i rafinuar, aciditeti nuk duhet të kalojë 0.5%.</p> <p>Amballazhimi nga 1-5 litër, qelqi ose plastike transparente me etiketë ku të shënohen standartet. Nuk duhet të jetë i përzier me vajra të tjerë dhe konservantë.</p>
10.	Salcë gjelle (domate)	<p>Kërkohet salcë domate e përpunuar me bazë vetëm domate, prodhim vendi ose i huaj.</p> <p>Malli të jetë i ambalazhuar në kuti llamarine ose shishe qelqi me peshë 500 deri në 1000 gr.</p> <p>Përmbajtja të jetë salcë dhe kripë.</p> <p>Përbërja e masës të jetë homogjene dhe me 18-20% lëndë e thatë.</p> <p>Nuk lejohen përbërës të tjerë dhe lëndë të huaja, ngjyra e salcës të jetë e kuqe e thellë, shija të jetë e ëmbël pa shumë aciditet, aroma të jetë e këndëshme në përputhje me aromën e domates së freskët karakteristike e llojit. Kapaku të jetë i mbyllur hermetikisht dhe me afatin e skadencës. Nuk lejohet me afat perdorimi më shumë se një vit.</p>
11.	Kripë e bardhë (e jodizuar)	<p>Të jetë e cilësisë së mirë, e ambalazhuar në pako 0.2 - 0.5 kg.</p> <p>Pamja: masë e përhedhur dhe e përbërë nga kristale të imta e të njëllajta.</p> <p>Ngjyra: e bardhë me shkëlqim.</p> <p>Treguesit shqisor: me shije karakteristike të</p>



		kripur, pa erë të huaj, me përdorim të njëtrajtshëm, e tretëshme plotësisht në ujë.
12.	Gjalpë lope	<p>Pamja: E njëtrajtshme pa shtresa në prerje me sipërfaqe të shndritur pa pika uji dhe mbeturina dhalli.</p> <p>Ngjyra: Gjalpi i freskët ngjyra, krem deri në të verdhë të çelur. Gjalp i kripur ngjyra e bardhë deri në të verdhë, karakteristike e kremës nga e cila prodhohet e njëllajtë në të gjithë masën.</p> <p>Treguesit fiziko kimikë:</p> <p>1- Lagështira në (%), jo më shumë se 17.</p> <p>2- Lëndët e thatë pa yndyr në (%), jo më shumë se 2.</p> <p>3-Yndyra në (%), jo më pak se 81 gjalpi i freskët dhe 79 gjalpi i kripur.</p> <p>4-Kripë në % jo më shumë se 2 gjalpi i kripur.</p> <p>5-Ngarkesa mikrobike brenda normave të lejuara nga Ministria e Shëndetësisë.</p> <p>6. Ambalazhimi: Gjalpi i freskët dhe i kripur ambalazhohet në kuti kartoni të valëzuar me masë 100 gr – 5 kg, (sipas kërkesës së entit), të veshur nga brenda me letër pergamen.</p>
13.	Reçel (qershi, kumbull, pjeshkë)	<p>Treguesit cilësorë të reçelit</p> <p>1. Pamja e jashtme: Jo e shëndritshme, e pasheqerosur, me sipërfaqe të njëllajtë, ku shënja myku dhe fermetimi nuk lejohen, pa pjesë të djegura, fletë fruti të qershisë, kumbull, pjeshkë, fara dhe pjesë të fermetuara.</p> <p>2. Ngjyra: E njëllajtë, karakteristike e frutit të qershisë, kumbullës dhe pjeshkës.</p> <p>3. Shija dhe era: Me erë të pëlqyeshme, karakteristike e frutit të qershisë kumbullës dhe pjeshkës, pa erë të huaj. Shija të jetë e pëlqyeshme, e ëmbël pa shije karamalizimi e fermetimi, pa shije të hidhur ose çfarëdo shije tjetër të huaj.</p> <p>Treguesit kimik:</p> <p>1. Lëndë reduktuese (sheqer invert) jo më shumë se 0,1%.</p> <p>2. Lagështia jo më shumë se 0,16%.</p> <p>3. Hiri jo më shumë se 0,07%.</p> <p>Ambalazhimi:</p>

		-Të jetë i ambalazhuar hermetikisht në kavanoza qelqi, apo plastikë me peshë 1-5 kg.
14.	Thjerrza (kokërr vogël)	Kërkohe cilësia e parë, të jenë të freskëta, të ambalazuara dhe të mos përmbajë dëmtues apo insekte. Ambalazhimi brenda kushteve higjeno-sanitare, dhe në etiketë të përmbajë peshën neto, datën e prodhimit, datën e skadencës. Paketimi të jetë në masën nga 0.4 – 1 Kg
15.	Sodë buke	Të jetë pluhur me ngjyrë të bardhë, me erën karakteristike të sodës së bukës. Të mos ketë lagështirë dhe erëra të huaja. Ambalazhimi: me pako/qese celefoni me peshë nga 100-500 gr.
16.	Çaj (mali, kamomil, boronic)	Të jetë i cilësisë së mirë. Të ketë karakteristikë erën e mirë të çajit të malit, kamomilit dhe boronicës. Të jetë i ruajtur në gjendje të thatë, pa lagështirë. Ambalazhimi: I paketuar në kuti kartoni ku secila prej saj të përmbajë 20 bustina.
17.	Kafe turke (e bluar)	Kafja duhet të jetë e bluar, me paketim 100 gr, aroma karakteristike e kafes, mos të ketë erëra të huaja. Afati i skadencës jo më pak se 6-muaj.
18.	Bizele kokërr (e ngrirë)	Pamja e jashtme: Të njoma, të freskëta, të pastra e të pacara, me ngjyrë të kultivarit, me pjekuri teknike dhe madhësi normale të kultivarit. Ambalazhimi të jetë sipas standartit me peshë nga 250 – 1000 gr.
19.	Barbunja (bishtaja)	Pamja e jashtme: Të freskëta, të shëndosha të pastra, me fije normale për kultivarin dhe me fara që duken lehtë, me formë të drejtë, lehtësisht të deformuara. Me formë prizmi shumëkëndësh që ngushtohet në majë, të padrunjëzuara e pa fije. Gjatësia në cm -Bishtaja frutshkurtër deri 6 cm - Bishtaja frutgjatë deri 8 cm Dëmtime të ndryshme (mekanike, sëmundje nga kimikatet) Lejohet deri në 5% të partisë me vyshkje të lehtë. Nuk lejohen me sëmundje e dëmtues. Ngjyra: Tipike për kultivarin. Lejohen deri ne 5% të masës me ngjyrë tjetër, me përjashtim të

		<p>ngjyrës së zezë.</p> <p>Ndërtimi i frutit: Fruta të butë me fara të vogla në fazën e qumështit. Lejohen me fruta jo të pjekura deri në 2% të masës.</p>
20.	Presh	<p>Kërkohet cilësia e mirë, të jetë i freskët, i njomë, i pastër, me ngjyrë të bardhë e jeshile, i pa vyshkur dhe i larë me ujë të pijshëm.</p> <p>Diametri në pjesën më të trashë të jetë mbi 2.5 - 3.5 cm.</p> <p>Gjatësia e kërcellit të jetë 25 - 45 cm.</p> <p>Gjatësia e gjethit nga rozeta të jetë jo më shumë se 20 cm.</p> <p>Sistemi rrënjor të jetë jo më shumë se 1cm.</p>
21.	Domate	<p>Kërkohet domate e cilësisë së mirë, ku të jenë të freskëta, me formë tipike të kultivarit, të plota, të pastra, të pa vrara, të pa shtypura, pa kalbje dhe pa njolla nga djegia e diellit, të pa prekura nga sëmundjet dhe dëmtuesit si dhe të pa lagura.</p> <p>Pjekuria duhet të jetë normale, me ngjyrë te kuqe, lehtësisht rozë dhe jeshile rreth bishtit.</p> <p>Nuk lejohen domate të tejpjekura, të zbutura e të vyshkura.</p> <p>Madhësia e kokrrës të jetë: Për të hershmet 3-4 cm; për të mesmet e të vonat 7 cm.</p>
22.	Kastravec	<p>Kërkohet i cilësisë së mirë, të jetë i drejtë, pa deformime, nuk lejohen kalbëzime si dhe nuk duhet të ketë njolla me ngjyrë të verdhë.</p> <p>Produkti të ketë pjekuri natyrale.</p>
23	Qepe thatë	<p>Kërkohet cilësia e mirë, të jetë me pjekuri të plotë, me cipë e bisht të thatë, të shëndosha e të plota, me ngjyrë e formë tipike të kultivarit dhe me gjatësi të bishtit deri në 7 cm.</p> <p>Madhësia e kokrrës për ovalet të jetë nga 4 deri në 5 cm.</p> <p>Lejohen jo më shumë se 1 % e partisë me dëmtime të lehta dhe 1 % lëndë të huaja.</p>

		Të ngrira, të kalbura e të mykura nuk lejohen.
24	Hudhër e thatë	Pamja e jashtme: Me pjekuri të plotë. Me cipë e bisht të thatë, të shëndosha e të plota. Me ngjyrë e formë tipike të kultivarit dhe me gjatësi të bishtit deri në 4 cm. Të lidhura në varg ose me rrjeta deri në 250 gr. Dëmtime mekanike cifla, bishta, sëmundje, lejohen jo më shumë se 1 % e partisë me dëmtime të lehta dhe 1 % lënde të huaja (cifla, bishta). Me sëmundje nuk lejohen.
25	Patate	Kërkohet cilësia e mirë, të jetë e plotë, të forta, të pastra e të thata, jo jeshile, jo të mbira me ngjyrë dhe me sytha tipikë të kultivarit. Kokrra të jetë e pjekur. Madhësia e kokrrës të jetë për pataten dimërore mbi 5 cm dhe për ato verore mbi 4 cm. Nuk lejohen të gjelbëra, të vyshkura, të mbira, të çara e të prera, të kalbura, njolla boje hiri e ndryshku, dëmtime nga krimbi, dhe të papastruara nga dherat. Duhet të jenë të ambalazhuara në thasë rrjete.
26	Kokërrlakër (e bardhë)	Kërkohet cilësia e mirë, të jenë të zhvilluara, me mbështjellje fletësh, e fortë në prekje. Lejohen lakra të pa ngjeshura deri në 5 % të partisë. Të jenë të pastra dhe me 2-3 gjethe të gjelbëra, të lidhura me koçanin i cili të jetë deri në 3 cm. Lejohen deri në 5 % e partisë me dëmtime të lehta mekanike, të çara lehtësisht e të shpërthyera si dhe të dëmtuara lehtësisht nga bryma.
27	Specë	Kërkohet cilësia e mirë, të jenë me formë e ngjyrë të kultivarit, të freskëta, të pastra dhe me pjekuri natyrale. Lejohen dëmtime jo më shumë se 3%. Shija të jetë karakteristike e kultivarit. Nuk lejohet perzierja e specave djegës me ato jo djegës. Gjatësia të jetë për të gjatat mbi 10 cm dhe për të rumbullaktat mbi 7 cm.
28	Patëllxhan	Kërkohet cilësia e mirë, të jenë të freskët, të

		<p>pastër, me sipërfaqje të lëmuar, me ngjyrë të zezë në manushaqe, me pjekuri normal, me fletë jeshile me nuanca të dobëta manushaqe, të pa vyshkura. Dëmtime të ndryshme e sëmundje nuk lejohen. Për të gjatët kërkohet diametrik jo më shumë se 5 cm dhe gjatësia 15-20 cm. Gjatësia e bishtit të jetë jo më shumë se 4 cm.</p>
29	Karrotë	<p>Kërkohet e cilësisë së mirë me gjatësi nga 8 deri në 10 cm, nuk lejohen kalbëzime ndryshk, nuk duhet të ketë njolla me ngjyrë jeshile pasi janë shkaktarë të aciditetit dhe sëmundjeve.</p>
30	Mollë	<p>Pamja e jashtme: pjekuria, era dhe shija të freskëta, me zhvillim normal, të shëndosha e me bisht. Me formë, ngjyrë e shije të kultivarit, pa deformime me 3 pjekuri teknike të njëjtë. Madhësia e kokrres: Kultivarët me kokërr të zgjatur jo më pak se 70 mm. Kultivarët me kokërr të rrumbullakët jo më pak se 80 mm. Kultivarët me kokërr të vogël jo me pak se 60 mm. Dëmtime mekanike nuk lejohen. Të prekura nga sëmundjet dhe insektet nuk lejohen. Të kalbura, të ngrira, njolla nga kalbëzimi si dhe çdo dëmtim tjetër nuk lejohet. Ambalazhimi dhe etiketimi: Frutat ambalazhohen të ndara sipas kultivarëve në arka të prodhuara sipas standarteve dhe kushteve teknike në fuqi për çdo lloj fruti dhe të jenë të pastra.</p>
31	Portokalle	<p>Pamja e jashtme: të freskët, me zhvillim normal, të shëndoshë dhe me bisht. Para dhe pas 15 Janarit lejohen kokrra pa bisht përkatësisht 5 dhe 20 %. Me pjekuri teknike të plotë. Ngjyra, shija dhe aroma të jenë karakteristike e kultivarit të verdhë në portokalli me erë karakteristike dhe shije të ëmbël në të athët, pa shije të hidhur. Dëmtime mekanike nuk lejohen. Të prekura nga sëmundjet dhe insektet nuk lejohen. Të kalbura, të mykura dhe të fermentuara nuk lejohen. Lëndë të huaja nuk lejohen. Gërvishtje në sipërfaqe por pa prekur tulin nuk lejohen. Zbutje të kokrrave, ngrirje dhe lagie të sipërfaqes së tyre nuk lejohen.</p>

		<p>Ambalazhimi dhe etiketimi: Frutat ambalazhohen të ndara sipas kultivarëve në arka të prodhuara sipas standarteve dhe kushteve teknike në fuqi për cdo lloj fruti.</p>
32	Manderina	<p>Pamja e jashtme: të freskët, me zhvillim normal, të shëndoshë dhe me bisht. Para dhe pas 15 Janarit lejohen kokrra pa bisht përkatësisht 5 dhe 20 %. Me pjekuri teknike të plotë. Ngjyra, shija dhe aroma të jenë karakteristike e kultivarit të verdhë në portokalli me erë karakteristike dhe shije të ëmbël në të athët, pa shije të hidhur. Dëmtime mekanike nuk lejohen. Të prekura nga sëmundjet dhe insektet nuk lejohen. Të kalbura, të mykura dhe të fermentuara nuk lejohen. Lëndë të huaja nuk lejohen. Gërvishtje në sipërfaqe por pa prekur tulin nuk lejohen. Zbutje të kokrrave, ngrirje dhe lagje të sipërfaqes së tyre nuk lejohen. Ambalazhimi dhe etiketimi: Frutat ambalazhohen të ndara sipas kultivarëve në arka të prodhuara sipas standarteve dhe kushteve teknike në fuqi për cdo lloj fruti.</p>
33	Bukë gruri	<p>Lloji: Bukë gruri me miell me rreze 75 %.</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Korja: E lëmuar, pa flucka, pa çarje e pjesë të djegura dhe pa shkëputje të saj nga tulli. Me ngjyrë të njëllojtë mjalti në të kuqërremtë.</li> <li>2. Tuli: Masë e njëllojtë e pjekur mirë, jo e ngjitshme, me pore të shpërndarë në mënyrë të njëllojtë dhe pa gjurmë mielli të pabrumosura. Konsistenca elastike, jo i thërmueshëm, pa shtresa.</li> <li>3. Era dhe shija: E këndëshme e bukës së pjekur mirë, pa erë dhe shije të hidhur, të thartë, myku ose te huaj.</li> <li>4. Forma: E rregullt, pa shtypje e deformime.</li> <li>5. Lëndët e huaja: Nuk lejohen.</li> <li>6. Treguesit kimik:</li> </ol> <p>Në përputhje me Standartin Shtetëror Shqiptar. Lagështira në % jo më shumë se 45 Poroziteti në % jo më pak se 70 Aciditeti në gradë jo më shumë se 4.5</p> <p>Ambalazhimi: Çdo bukë të futet në qese letre e pastaj në qese telefoni me masën 1000 gr, këto të futura në kuti kartoni.</p>

		<p>Buka duhet të jetë e prerë në feta.</p> <p>Transporti i bukës: Bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga dëmtimet e faktorët e tjerë atmosferik duke zbatuar rregullat higjieno - sanitare për transportimin e produkteve ushqimore.</p>
34	Mish pule	<p>Mish pule i freskët;</p> <p>Pamja e jashtme: Me ngjyrë rozë e çelur që anon në të bardhë karakteristik e mishit të pulës së freskët, pa shtresa të tepruara dhjami, cilësi e mirë.</p> <p>Ndarja anatomike: Mishi i pulës do të përbëhet nga të gjitha pjesës e pulës.</p> <p>Paketimi: Të jetë në kuti kartoni ku të jetë shënuar pesha dhe data e skadencës së produktit.</p>
35	Mish viçi	<p>Kërkohet mish viçi në rritje (mosha 6-12 muaj) me cilësi që të plotësoj kërkesat e standarteve.</p> <p><b>Pamja e jashtme:</b> Siperfaqja e jashtme të jetë e mbuluar me një cipë të hollë tharje. Siperfaqja e mishit të ftohur menjëherë pas prerjes të jetë i tejdukshëm. Tendinat të jenë të ndritshme, elastike dhe të forta.</p> <p><b>Ngjyra:</b> Mishi të jetë me ngjyre rozë dhe i dhjamt të jetë me ngjyrë të bardhë.</p> <p><b>Konsistenca:</b> Të jetë e butë dhe elastikë. Në prerje të duket kompakt.</p> <p><b>Era:</b> Të jetë e këndshme, karakteristike e llojit të mishit të viçit.</p> <p><b>Palca e kockave:</b> Të mbushi të gjithë kanalën e palcës, ngjyra të jetë rozë në të Verdhë, cdo pjesë, të jetë e vulosur me vulën e inspektoriatit veterinar.</p> <p>Çdo parti mishi shoqërohet me certifikatën veterinare me të cilën vërtetohet se nga kontrolli i kryer nuk është prekur nga sëmundje por që është i sigurt dhe se lejohet të tregtohet për konsum publik.</p>
36	Djadhë i bardhë (lope)	<p>Kërkohet cilësia e mirë, me bazë prodhim djathi n/produkt i qumështit të lopës. Nuk lejohet prodhim i djathit me përzierje qumësht pluhur ose të kondensuar.</p>

		<p>Djathi të ketë kaluar periudhën e stazhionimit mbi 3 muaj.</p> <p>Ngjyra të jetë sipas llojit të qumështit, djathë lope, në ngjyrë të qumështit (krem). Lejohet djathë me përqindje yndyre jo më shumë se 3 %. Pamja e jashtme të jetë konform, në brendësi poroze karakteristike e djathit të stazhionuar mirë. Sasia e kripes të jete normale. Shija të jetë e mirë karakteristike e djathit normal pa erëra të tjera jo të këndshme, i ambalazhuar në kuti plastike (me shëllirë). Afati i skadencës jo me pak se 6-muaj.</p>
37	Qumësht lope	<p>Qumështi të jetë qumësht lope i cilësisë së mirë me 2+ - 0.1% yndyrë, 12% lëndë të thatë dhe aciditet 21%, me ngjyrë të bardhë dhe erë karakteristike. Qumështi të jetë i pasterizuar. Qumështi të jetë i freskët dhe i shoqëruar me dokumentacion që provon cilësinë dhe sigurinë e tij, duhet të tregtohet në enë të mbyllura.</p>
38	Vezë pule	<p>Vezë Pule bazuar në STASH 1515-85 ose ekuivalentin e tij.</p> <p>Vezët të jenë të stampuara ku të dallohet qartë origjina e mallit.</p> <p>Të jenë të vendosura në bikurina, të jenë me peshë nga 55 deri 70 gr për/kokërr, të padëmtuara, dhe brenda afatit të skadencës.</p>
39	Banane	<p>Kërkohe cilësi e parë, të freskëta, me zhvillim normal, në tufë, me pjekuri teknike të plotë.</p> <p>Ngjyra të jetë jeshile në të verdhë, me erë dhe aromë të këndshme, karakteristike e këtij kultivari.</p> <p>Madhësia e kokrrës të jetë mesatare.</p> <p>Dëmtime mekanike nuk lejohen.</p> <p>Njolla të kafta që tregojnë tejkalimin e pjekurisë nuk lejohen.</p> <p>Gërvishtje të lëkurës nuk lejohen.</p> <p>Zbutje të lëkurës nuk lejohen.</p> <p>Ambalazhimi të jetë në kuti kartoni standarde tipike për tregëtimin e bananes.</p> <p>Malli të jetë i shoqëruar me etiketen e cilësisë.</p>
40	Miell orizi	<p>Të jetë i cilësisë së parë, me ngjyrë të bardhë, pa as edhe një njollë apo ngjyrë tjetër. Era dhe shija të jenë karakteristike e miellit të orizit, pa erë myku, pa shije të hidhur apo të thartë. Në ambalazh të shkruhet data e skadencës dhe</p>



		përmbajtja në gjuhën shqipe. Nuk lejohen dëmtues.
41	Djall kaçkavall (lope)	<p>Klasifikimi:  - Djathë (kaçkavall)  - Lloji: lope  Kërkesat cilësore  Treguesit shqisorë:  - Pamja e jashtme: Me kore të formuar mirë dhe të pastër. Lejohen dëmtime të lehta mekanike deri në 5% të sipërfaqes. Nuk lejohen shenja myku, kalbëzimi dhe fryrje. Sipërfaqja e parafinuar me ngjyrë kremi deri në të verdhë. Në prerje homogjene e lëmuar. Pa lëndë të huaja, pa ndarje shtresash, me sytha teknike me ngjyrë kremi në të verdhë.  - Era dhe shija: E këndshme karakteristike e djathit të stazhionuar, pa shije të hidhur dhe djegëse dhe pa shije e aromë të huaj.  Treguesit fiziko-kimik:  - Lëndët e thata në % jo më pak se 58.  - Yndyra në lëndët e thata në % jo më pak se 50.  - Kripë në % jo më shumë se <math>3.5 \pm 0.5</math>.  - Përmbajtja mikrobiale: Sipas normave të miratuara nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.  Ambalazhimi duhet të sigurojë cilësi higjienike, ushqimore, teknologjike dhe organo-leptike të produktit duhet të jetë i sigurt dhe i përshtatshëm për qëllimin e përdorimit. Ambalazhimi në qese plastike të përshtatshme dhe të lejuara për ambalazhimin e këtij produkti, me masë sipas kërkesave të AK-së.</p>
42	Kungull (i njomë)	<p>Lloji: Kungull për treg, cilësia e mirë.  Kërkesat cilësore: Pamja e jashtme: Të freskët me ngjyrë e formë tipike të kultivarit, me përkulje të lehtë.  Me tul jo shumë të fortë. Farat e pa zhvilluara e me lëkurë të lëmuar. Madhësitë:  Gjerësia në cm (diametrik më i madh ) deri 3. Gjatesia në cm nuk kërkohet.  Dëmtime mekanike (gërvishtje të lehta në lëkur) në % jo më shumë se 2.  Të prekura nga insektet të kalbura nuk lejohen.  Ambalazhimi dhe etiketimi  Të ambalazhohet i ndarë sipas kultivarëve në</p>

		arka të pastra të forta e të thata të prodhuara sipas standartit ose kushtit teknik.
43	Lëng limoni	Lëng Limoni Shija dhe era: Të jetë me erë dhe shijen e limonit të freskët. Të jetë i ambalazhuar nëshishe plastike me peshë 250- 330 ml. Në shishe të jetë e shënuar: Emërtimi i prodhuesit; Emërtimi i produktit; Pesha neto; Data e skadimit; Kushtet e vecanta të ruajtjes së produktit.
44	Çokokrem (krem çokollate)	Përbërësit: sheqer, vajra vegjetal pjesërisht të hidrogjenizuara (vaj farash pambuku, vaj bërthamash palme), hurrë pluhur, laktozë, kakao pluhur (10-12% yndyrë) 3%, lajzhi 1%. Produkti mund të përmbajë edhe sasi të vogla frutash të tjera të thata, proteina qumështi dhe proteina gruri. Ambalazhimi: -Të jetë i ambalazhuar hermetikisht në kavanoza qelqi, apo plastikë me peshë 1-5 kg. Afati i skadencës jo më pak se 1 vitë data e lëvrimit të mallit.

**Shënim:** Në zbatim të nenit 36 të Ligjit Nr. 162 datë 23/12/2020 “Për prokurimin publik” në të gjithë rastet kur në DT, Specifikime Teknike apo çdo dokument shoqërues është cituar ndonjë markë, përfshihet termi “ose ekuivalent i tij/i saj”, pasi në çdo rast emërtimi është bërë për arsye orientimi dhe nuk ka efekt kufizues apo përjashtues.

**Kudo në Specifikimet Teknike ku mund të jetë cituar Standart Ndërkombëtar do të pranohet edhe cilësim ekuivalent nga një institut vendor i akredituar në RSH.**

**Shtojca 6****FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT****Sasia e mallit që kërkohet:**

<b>Nr</b>	<b>Emërtimi</b>	<b>Njësia</b>	<b>Sasia</b>	<b>Afati i lëvrimit të mallrave</b>
1	Makarona spageti (të gjata)	kg	370	12 muaj pas nënshkrimit të kontratës
2	Makarona fidhe (të shkurtra)	kg	150	12 muaj pas nënshkrimit të kontratës
3	Oriz (kokër rrumbullakë)	kg	400	12 muaj pas nënshkrimit të kontratës
4	Sheqer	kg	170	12 muaj pas nënshkrimit të kontratës
5	Fasule	kg	140	12 muaj pas nënshkrimit të kontratës
6	Miell gruri	kg	280	12 muaj pas nënshkrimit të kontratës
7	Miell misri	kg	25	12 muaj pas nënshkrimit të kontratës
8	Vaj gjelle luledielli	litër	260	12 muaj pas nënshkrimit të kontratës
9	Vaj ulliri	litër	155	12 muaj pas nënshkrimit të kontratës
10	Salce gjelle (domate)	kg	53	12 muaj pas nënshkrimit të kontratës
11	Kripë e bardhë e jodizuar	kg	57	12 muaj pas nënshkrimit të kontratës
12	Gjalp lope	kg	97	12 muaj pas nënshkrimit të kontratës
13	Reçel (qershie, kumb, pjesh)	kg	140	12 muaj pas nënshkrimit të kontratës
14	Thjerrza (kokër e vogël)	kg	50	12 muaj pas nënshkrimit të kontratës
15	Sodë buke	kg	5	12 muaj pas nënshkrimit të kontratës
16	Çaj (mali, kamomil, boronic)	Bustina	2000	12 muaj pas nënshkrimit të kontratës
17	Kafe turke (e bluar)	kg	20	12 muaj pas nënshkrimit të kontratës
18	Bizele kokërr (e ngrirë)	kg	175	12 muaj pas nënshkrimit të kontratës
19	Barbunja (bishtaje)	kg	50	12 muaj pas nënshkrimit të kontratës
20	Presh	kg	100	12 muaj pas nënshkrimit të kontratës
21	Domate	kg	280	12 muaj pas nënshkrimit të kontratës
22	Kastravec	kg	150	12 muaj pas nënshkrimit të kontratës
23	Qep e thatë	kg	335	12 muaj pas nënshkrimit të kontratës
24	Hudhër e thatë	kg	10	12 muaj pas nënshkrimit të kontratës
25	Patate	kg	1330	12 muaj pas nënshkrimit të kontratës
26	Kokërlaker (e bardhë)	kg	30	12 muaj pas nënshkrimit të kontratës
27	Specë	kg	150	12 muaj pas nënshkrimit të kontratës
28	Patëllxhan	kg	140	12 muaj pas nënshkrimit të kontratës
29	Karrotë	kg	410	12 muaj pas nënshkrimit të kontratës
30	Mollë	kg	840	12 muaj pas nënshkrimit të kontratës
31	Portokalle	kg	180	12 muaj pas nënshkrimit të kontratës
32	Mandarina	kg	150	12 muaj pas nënshkrimit të kontratës
33	Bukë gruri	kg	2335	12 muaj pas nënshkrimit të kontratës
34	Mish pule	kg	320	12 muaj pas nënshkrimit të kontratës
35	Mish viçi	kg	640	12 muaj pas nënshkrimit të kontratës

---

36	Djath i bardhë (lope)	kg	251	12 muaj pas nënshkrimit të kontratës
37	Qumësht lope	litër	3550	12 muaj pas nënshkrimit të kontratës
38	Vezë pule	kokër	6300	12 muaj pas nënshkrimit të kontratës
39	Banane	kg	590	12 muaj pas nënshkrimit të kontratës
40	Miell orizi	kg	20	12 muaj pas nënshkrimit të kontratës
41	Djath kackavall lope	kg	10	12 muaj pas nënshkrimit të kontratës
42	Kungull i njomë	kg	80	12 muaj pas nënshkrimit të kontratës
43	Lëng limoni	litër	5	12 muaj pas nënshkrimit të kontratës
44	Çokokrem (krem cokollate)	kg	70	12 muaj pas nënshkrimit të kontratës

**Afatet e lëvrimit:** Mallrat e kërkuara objekt prokurimi do të dorëzohen në magazinën e Autoritetit Kontraktor duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës me operatorin ekonomik fitues të kësaj procedure për një afat 12 Muaj.

**Mënyra e furnizimit:** Sasitë e lëvrimit të mallit do të përcaktohen në kërkesat periodike (javore ose mujore) që do të bëhen prej Autoritetit Kontraktor bazuar në nevojat e tij.

---

## Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

### FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

#### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që vepron si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

---

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

### **Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfasuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;
- c. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1, të shoqëruar me listën e çmimeve të artikujve sipas Shtojcës 2;

### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

#### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

Sipas kriterëve të përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit, pika 1 e Shtojcës 7.

#### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Vërtetim xhiroja vjetore e operatorit ekonomik ofertues gjatë 3 (tre) viteve të fundit (2021, 2022, 2023) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së parashikuar e kontratës dhe kjo të jetë e vërtetuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore me shkresë ose me dokument të nxjerrë online me vulë elektronike. **Ky kriter konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.**

---

**2.2.2** Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit financiarë (2021, 2022, 2023) të paraqitur në Autoritetet përkatëse Tatimore, të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar. (Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse bilancet janë në përputhje me parashikimet e nenit 43/4 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar)

**Shënim:** Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit Nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

**2.2.3** Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2023 dhe këstin përkatës të maturuar për vitin 2024, sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar).

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

*(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit; dokumentet përkatëse vërtetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).*

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

**Përsa i përket aftësisë teknike, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, si më poshtë vijon:**

**2.3.1 Dëshmi për furnizime të ngjashme të mëparshme** në një vlerë jo më të vogël se **20%** e vlerës së përlllogaritur të kontratës, për të cilën konkuron operatori ekonomik, që është realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës si më poshtë:

- a.** Autoriteti Kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një Ent Publik, Kontrata furnizimi dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat, sasitë e mallrave të furnizuara dhe të jenë të deklaruar në organet tatimore.
- b.** Në rastin e përvojes së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat, sasitë e mallrave të furnizuara dhe të jenë të deklaruar në organet tatimore.

---

**2.3.2** Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë në emër të tij Licencën me kodin II.1.A.1 "Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz" Në rastet kur operatorët ekonomikë, nuk kanë detyrim ligjor të licencohen nga Qendra Kombëtare e Biznesit me këtë licencë, duhet të paraqesin e Ekstraktin Tregtar të subjektit, ku në fushën e veprimtarisë së tij të jetë i përfshirë edhe objekti që prokurohet.

**2.3.3** Operatorët ekonomik duhet të vërtetojnë se e zhvillojnë aktivitetin e tyre në fushën objekt prokurimi në përputhje me standardet e menaxhimit të cilësisë. Për këtë subjekti ofertues duhet të paraqesi certifikatën e mëposhtme:

- Certifikatë **ISO 9001:2015** mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” (e vlefshme), lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituara për këtë qëllim;

**2.3.4** Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqes një deklaratë, me anë të së cilës duhet të vetëdeklarojë se, nga kontrolli i fundit i ushtruar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore. Operatori ekonomik i shpallur fitues përpara lidhjes së kontratës ka detyrim të paraqesë dokumentacionin provues ku të provohet se nga kontrolli i fundit i AKU-së ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të Dokumentave Standarte të Tenderit (DST).

**2.3.5** Në rast se operatori ekonomik nuk është prodhues i produkteve si bukë, vezë, qumësht dhe nënprodukte të tij, mish dhe nënprodukte të tij, duhet të paraqesë kontratë/marrëveshje noteriale furnizimi për këto produkte me subjekte të ndryshëm që kryejnë aktivitetin në këto fusha.

**2.3.6** Subjekti ofertues duhet të këtë në pronësi ose me qera, nëpërmjet aktit të pronësisë ose kontratës noteriale të qerasë, për të gjithë periudhën e zbatimit të kontratës, 2 (dy) mjete transporti të përshtatshëm për transportin e produkteve ushqimore, të shoqëruar me Leje qarkullimi, Policë sigurimi, Certifikatë e kontrollit teknik të mjetit, Fotot përkatëse ku të dallohet qartë targa e mjetit, ku njëri prej tyre të jetë ATP (frigorifer) ndërsa tjetri mjet ATV.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 të Dokumentave Standarte të Tenderit (DST).

**2.3.7** Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë (Me anë të një “**Deklarate**”), që merr përsipër transportin e mallrave objekt prokurimi në vendin e dorëzimit të kontratës (Magazina e Bashkisë Delvinë), brenda afatit të përcaktuar në Dokumentave Standarte të Tenderit për lëvrimin e mallit.



---

**Shënim:** Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “*Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.*”

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

---

**Shtojca 8**

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

**FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT**

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ në cilësinë e \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik  
\_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

**A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik**

<b>Identifikimi</b>	<b>Përgjigjja</b>
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	-----

**B: DEKLARATË**

